

Njoftim për përqendrim me të cilin Daimler Trak AG nga Gjermania, BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink. nga ShBA dhe NekstEra Enerxhi Ink. nga ShBA do të formojnë një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale

(Lënda nr. 08-122 të vitit 2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 20.09.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet formimit të një ndërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale dhe fitimit të kontrollit të përbashkët nga Daimler Trak AG me seli të regjistruar në Lajnfelden-Ehterdingen-Gjermani, BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink. me seli të regjistruar në 40 Ust rruga 52, Nju Jork, NY 1022, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NeksEra Enerxhi Ink me seli të regjistruar në 700 Junvrs Bulevard, Xhuno Biç, FL 33408, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, d.m.th. shoqëritë e tyre të lidhura dhe pjesët e barabarta në shoqërinë e një ndërmarrje përbashkët që do të ri themelohet.

Ndërmarrja e përbashkët kryesisht do të zhvillojë, ndërtojë, financojë, zotërojë dhe operojë me infrastrukturë të disponueshme publike të pikave/depove për karikim të automjetet të rënda elektrike, siç janë kamionët elektrik të mesëm dhe të rëndë me qeliza karburanti/hidrogjen, siç janë autobusët dhe autobusët turistikë për distanca të gjata dhe transport rajonal përgjatë korridoreve të caktuara në ShBA kontinentale dhe Kanada.

- Daimler Trak AG është e fokusuar në prodhimin dhe shitjen e kamionëve dhe autobusëve. Entiteti që përfundimisht e kontrollon Daimler Trak AG është Daimler Trak Holding AG.

Daimler Trak AG nuk ka shoqëri të varura të cilët janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

- BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink është një shoqëri nga ShBA, me aksionet e të cilit publikisht, në mënyrë aktive ofrojnë shërbime të menaxhimit global të investimeve, menaxhimit të riskut dhe shërbime këshillimore për institucionet dhe klientët me pakicë në mbarë botën. BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink. menaxhon mjetet në llogari të institucioneve dhe investitorëve individualë në mbarë botën. Për më tepër, përmes BlekRok Solushns, shoqëria ofron shërbime të menaxhimit të rrezikut dhe këshillimit që kombinojnë ekspertizën e tregut të kapitalit me sistemet dhe teknologjinë e BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink.

BlekRok Fajnenshal Manaxhment, Ink. nuk ka asnjë shoqëri portofoli që i kontrollon, e të cilat janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat kanë aktivitete në Maqedoninë e Veriut dhe që mund të çojnë në një marrëdhënie vertikale me ndërmarrjen e përbashkët.

NekstEra Enerxhi Ink. është një korporatë e themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Floridës, SHBA me zyrën dhe selinë e saj të regjistruar në Xhuno Biç, Floridë , ShBA. NekstEra Enerxhi Ink. është një nga shoqëritë më të mëdha të infrastrukturës së energjisë elektrike me Amerikën e Veriut dhe një lider në industrinë e burimeve rinovuese të energjisë.

NekstEra Enerxhi Ink. nuk ka shoqëri të varura të cilët janë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Tregu përkatës i mallrave për përqendrimin e propozuar mund të përkufizohet *si treg për instalimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të karikimit me akses publik, me fuqi të lartë për kamionët e rëndë dhe autobusët turistikë me bateri.*

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

22.09.2022

Shkup